

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

DËGJIM PUBLIK I
KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT

Prishtinë,
më 08.05. 2007

KOMISIONI PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI, KULTURË, RINI DHE SPORT

KRYETARI ENVER HOXHAI – Të nderuar zonja dhe zotëri, mirëseardhje në këtë takim me Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, mirëseardhje gjithë anëtarëve të grupit të Dablinit veçanërisht edhe për rektorit Luan Ahma. Meqë sot në këtë sall dhe në disa salla tjera mua si kryetar i Komisionit më është dash të akordojë agjendën vjetore që do ta ketë Kuvendi i Kosovës për periudhën e cila na pret këto 6 muaj të ardhshme ku nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës nga kryetari i Kuvendit z. Kolë Berisha është kërkuar që Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sporte t'i kryejë të gjitha obligimet para se të miratohet rezoluta e ardhshme se pas miratimit të Rezolutës së ardhshme në Këshill të Sigurimit, ne si Komision kemi një agjencë që duhet të jetë në shërbim të asaj çka thirret si fazë e tranzicionit ku duhet të miratohen një konklumerat i ligjeve.

Edhe ky takim i sotshëm është në përputhje shumë me atë se si ne si Komision po edhe ju si grup i Dablinit ku pjesë e cilit jemi edhe ne do të duhet të debatojmë rreth Ligjit për kornizë kombëtare të kualifikimeve.

Unë i falënderoj të gjithë të pranishmit veçanërisht zonjën Fikrije Zymberi dhe Z. Blerim Haliti prej të dy ministrive gjegjëse por edhe përfaqësuesit tjerë që janë të pranishëm në këtë takim meqë sot ka qenë një ditë pragmatike dhe ne kemi menduar që edhe në këtë takim të merrmi me arsye shumë pragmatike shumë konkrete. e kam ndërmend vetëm t'ju informojë në formë shumë të shkurtë në emër të Komisionit për ata të cilët janë të pranishëm në këtë takim që fillimisht do të ju shpërndajmë një kopje të vendimit të Kryesisë së Kuvendit në të cilën është miratuar iniciativa e Komisionit tonë për hartimin e kornizës kombëtare të kualifikimeve që çdo kush prej jush ta ketë nga një kopje edhe një herë ta dëshmojë përkushtimin e Komisionit që na jemi shumë të interesuar që edhe më tutje ta shtymë këtë iniciativë në një seancë të radhës të Kuvendit të Kosovës dhe mbi të gjitha edhe kërkesën e Kryesisë së Kuvendit që Ligji për kornizë kombëtare të kualifikimeve dhe Ligji për arsim privat i cili ndoshta ju takon krejt juve po neve si Komision dhe Ministrisë së Arsimit definitivisht po, do të duhej të kalojnë deri në fund të muajit majë gjegjësisht deri në gjysmën e qershorit të cilat janë ligje i pari është nga viti 2005 fillimi i vitit 2005 dhe i dyti është në shtator të viti 2005 si e keni edhe vendimin e Kryesisë së Kuvendit.

Ideja e këtij tatimi ka qenë më tepër ta shërojmë aspektin legal të iniciativës të ligjit po kuptohet që do të duhej dhe mund të bisedojmë dhe çdo debat është më e

mirëseardhur sa i përket procedurës së ardhshme sa i përket përmbajtjes të Ligjit për kualifikime sa i përket punës e cila është bërë deri më tash për të cilën ne si Komision prof. Nimon Alimushaj dhe unë personalisht që kemi qenë pjesë dhe jemi pjesë e grupit të Dablinit por anëtarët e tjerë. Ju falënderojmë për punën e bërë deri më tash. Me që prej anës tonë është shumë e qartë në bazë të letrës që ju e murrët. Kisha pas dëshirë që të ju përcjelli fjalën juve çka jeni të pranishëm Grup të Dablinit me qëllim që ta shohmi a jemi në dimensionin e njëjtë kohorë apo jemi duke folë për dy dimensione të ndryshme.

Me qenë gjithë të barabartë fjalën e ka kushdo që dëshiron, ose unë mund të shkoj dhe me hiarhi institucionale si të doni ju.

FIKRIJE ZYMBERI – Përshëndetje të gjithëve. Besoj që edhe një herë pata rastin këtu të jem pranë jush si Komision i Arsimit dhe do me thënë që atëherë, unë në realitet prezantova se çfarë kemi, të cilët janë hapat e mëtutjeshëm. Ne e kishim fillimisht një plan të veprimit, dhe normalisht në këtë plan të veprimit, të cilin e caktuam ne si Grup i Dablinit, që nuk kam nevojë ndoshta ta sqaroj prapë juve që e dini pse jemi quajtur si Grup i Dablinit, do me thënë kanë qenë të kyçur të gjithë aktorët, të gjithë bartësit e të gjitha institucioneve.

Është e vërtetë që këto procese janë udhëhequr nga unë si koordinatorë nga Ministria e Arsimit, nga që, do me thënë caktimi i tillë i koordinatorës ka ardhur nga politika ndërkombëtare, do me thënë që Ministria e Arsimit të ketë një koordinator për proceset e Kopenhagës.

Çështja është se ne vërtetë kemi arritur këtu rezultate, kemi siç e dini edhe ju e keni dokumentin për propozime për kornizën e kualifikimeve kombëtare të Kosovës, që kohën e fundit kemi pasur edhe një takim lidhur me atë se si të plotësohet niveli i pestë atje i Kornizës Evropiane apo niveli i katërt i skedit që në realitet nivel teknikut, që te ne për momentin paraqet si zbrazësi do me thënë me rastin e transformimit të shkollave të larta, ish shkollave të larta në Beqëll. Do me thënë aty na mbetet ta plotësojmë atë zbrazësi, kuptohet në bashkëpunim me të gjithë partnerët, dhe t’ju them të drejtën partneriteti në takimet ndërkombëtare ku kam prezantuar sa herë është çmuar shumë nga ndërkombëtarët sidomos kur kam treguar që në këtë grup kemi anëtar nga Komisioni i arsimit, do me thënë, që përkrahja politike ka qenë që nga fillimi shumë e madhe, dhe kjo ishte një befasi ndoshta në këto takime nga që vendet e rajonit kishin shumë problem në arritjen e konsensusit për çështjet shumë më pak të rëndësishme, e lere më për proceset të cilat ka një interes të gjithmbarshëm kombëtar. Ndoshta, themi, ishte rasti i punëtorisë së fundit kur, edhe z. Enver ishte, unë sadopak ndoshta u preka kur u tha që marrëveshja nuk është respektuar, që iniciativa e Komisionit ka qenë që të hartoj

Ligjin për kornizën kombëtare të kualifikimeve, ndërsa ne punonim për Kornizën. Por, megjithatë unë prapë them se është bërë një punë e madhe, është bërë nga të gjitha institucionet, do me thënë nga të gjithë partnerët dhe është një punë, ma merr mendja që duhet çmohet, është një bazë e mirë. Unë edhe atë ditë thashë nuk është me rëndësi ndoshta për mua si person se a do të shkoj ky ligj për kornizën kombëtare të kualifikimit nga Ministria e Arsimit, apo nga Komisioni i arsimit, është momenti, është koha që mos të debatojmë rreth këtyre çështjeve se kush – çka, por vërtetë të ofrohet një bazë e mirë ligjore që ka të bëjë me interesin e përgjithshëm kombëtar, se shumë çështje të cilat janë diskutabile besoj se do të rregullohen përmes këtij ligji. Dhe me siguri ju e keni marrë edhe draftin final që është punuar në punëtori, janë futur disa ndryshime dhe normalisht ne prej fillimit kemi pasur përkrahjen nga Programi Kosfet, ju veç e dini është program që e përkrahë arsimin dhe aftësimin, që financohet nga Agjencioni Evropian, kemi pasur gjithmonë mbështetjen nga z. Dejvid Hendlli dhe kohën e fundit për këto ndryshime të cilat i kemi futur në ligj kemi pasur përkrahjen e madhe dhe nga ekspertët për kualifikime Gjon Har që ishte nga Skotlanda dhe kishte një përvojë të mirë në këtë fushë në Shqipëri dhe në Turqi, neve na mbetet që draftin e keni dhe më tutje të vendosim bashkarish si, veç është d.m.th. kanë në qoftë se ne nuk vazhdojmë procesin e mëtutjeshëm që deri më tani ka shkuar në mënyrë shumë të mirë.

Vetë përfshirja e gjithë këtyre bazave tregon që ka qenë një konsensus i mirë mes gjithë partnerëve dhe ne këtu besoj edhe tjerë anëtarë të grupit të Dablinut nuk di a do të quhemi më grup i Dablinut a jo se ne realizuam edhe dy vizita tjera studimore një ishte në Maltë dhe një Estoni dhe quhemi prapë grup i Estonianëve apo të quhemi grup punues. Po unë me gjitha atë unë do t'ia kisha dhënë fjalën edhe anëtarëve tjerë të grupit apo kushdo qoftë. Sa më përket mua unë jam e kënaqur që me një konsensus është arritur. Për mos përfshirjen e anëtarëve asnjëherë, as që kemi menduar të shkojmë në atë mënyrë. Po jemi munduar të zbatojmë atë se çfarë kemi shkruar në planin e veprimit, takimet ndërkombëtare kur kemi raportuar që në vitin 2006 të bëhet miratimi i ligjit për kornizën kombëtare të kualifikimeve dhe themelimi i autoritetit 2007.

Mirëpo atëherë bashkërisht e diskutuam s'di me anëtarët të gjithë, fatkeqësisht ju keni qenë shumë të nxanun edhe shumë herë nuk keni mujt me marrë pjesë. Po atëherë nuk ishte paraparë në legjislacionin e Kuvendit ligji dhe për këtë arsye nuk ishte prioritet kështu që për 2007 në atë plan të veprimit kemi futur që Ligji i kualifikimeve të miratohet nga Kuvendi këtë vit para majit dhe themelimi i autoritetit të bëhet vitin e ardhshëm ashtu siç e parasheh ky ligj. Ju jeni këtu prezentë dhe mund të thoni çka keni sugjerime ose propozime çfarë duhet vepruar më tutje. Faleminderit.

KRYETARI ENVER HOXHAI – Faleminderit z. Fikrije Zymberi. E kisha lut çdo përfaqësues që ta thotë emrin dhe mbiemrin para se të fillon me prezantimin e tij për hir të transkriptit i cili ta kem do të thotë do ta ketë edhe transkriptin, mund ta keni edhe secili prej jush mandej transkriptin të këtij takimi, kështu që vetëm ta theksoni emrin dhe mbiemrin e juaj.

Meqë filluam këtë formë nëse anëtarët e Komisionit janë të mendimit u kisha thënë fillimisht po dëgjojmë anën e juaj edhe pse nuk ju shohim si palë kështu si një grup se çfarë po mendoni sa i përket kësaj se çfarë ju thanë nga ana ime në emër të Komisionit dhe nga ana e z. Fikrije Zymberi dhe mandej mund të kyçen në debat edhe anëtarët e Komisionit me që takimi është i natyrës pragmatike a kuptohet që reflektimet e shkurtra janë shumë preferumë.

ZEQIR SHKODRA – Nëse nuk ka diçka me rendë dite. Falënderoj kryetarin e Komisionit për një paraqitje. Unë jam Zeqir Shkodra nga Bashkimi i sindikatave të pavarura të Kosovës në cilësinë e partnerit social dhe në cilësinë e anëtarit të Grupit të Dablinit.

Falënderoj kryetarin e Komisionit për një paraqitje përmbajtjesore dhe z. Fikrije si koordinatorë nacionale. Në cilësinë e anëtarit të Grupit të Dablinit jam i kënaqur që më në fund erdhëm deri te kjo fazë e shqyrtimit të Projektligjit për kualifikime i cili do të harmonizojë sistemin e arsimit dhe aftësimit në Kosovë me praktikën e rekomanduar ... të Bashkimit Evropian. Në këtë kontekst grupi punues në bashkëpunim edhe me ekspertë ndërkombëtarë të fushave përkatëse ka bërë përpjekje që ky projektligj të jetë sa më afër tregut të punës dhe segmenti i tij të ketë edhe cilësinë e mësimi si komponent kryesor për tregun vendor të punës dhe atë ndërkombëtarë.

Përkundër përpjekjeve të grupit që të hartohet një ligj funksional jam i vetishëm se ai nuk është i përkryer dhe ka vend për përmirësime sidomos nga aspekti terminologjik.

Kontributi i ekspertëve ndërkombëtarë si Devid Hendlli nga ... dhe Gjon Hart ishte i mirëseardhur por kontributi i jashtëzakonshëm në grupin punues dhanë edhe Komisioni i Kuvendit të Kosovës për Arsim Shkencë dhe Teknologji Enver Hoxhaj, Ragip Zekolli dhe Nimon Alimusaj. Të cilët me saje të përpjekjeve të tyre të palodhshme është shpejtuar procedura e aprovimit të Ligjit në Kuvendin e Kosovës.

Memorandumi sqarues i Projektligjit detalisht paraqet arsyet e nxjerrjes së ligjit problemet dhe çështjet që i trajton ligji, standardet, përgjegjësitë, kompetencat e organeve ekzistive, financimin, buxhetin, afatet e nxjerrjeve të akteve nënligjore dhe procedurat.

Kur theksova më lartë çështjen e terminologjisë mendoj se i gjithë grupi ka pasur vështirësi në gjetjen e termave adekuate në këtë ligj. Mirëpo besoj se me një lekturim profesional do të gjenden edhe termet adekuate. Nga ky aspekt mendoj që duhet të jemi të qartë të jepi edhe disa vërejtje sot.

Në faqen 9 para nenit 16 të Projektligjit në vend të fjalës që nuk është adekuate rregullimi dhënies së kualifikimit është mirë që të shkruhet procedura e dhënies së kualifikimeve apo rregullat e dhënies së kualifikimeve ashtu siç është në ligj besoj që nuk është një termin adekuat.

Pastaj te kapitulli VII faqe 12 fjala rregullime financiare nuk i përket çështjes së ligjit të fshihet dhe të mbetet burimet e financimit apo vetëm financimi. Besoj se është një shprehje më adekuate.

Po të njëjtën faqe para nenit 24 në vend të kontrollimit financiar të jetë auditimi financiar apo i kontrolli financiar që e bëjnë subjektet dhe institucionet tona..

Unë në tërësi e përkrahi memorandumin sqarues dhe e falënderoj tërë grupin punues por edhe institucionet dhe ekspertët të cilët kanë dhënë një kontribut të çmuar në hartimin e këtij Projektligji. Ju faleminderit.

KRYETARI ENVER HOXHAJ - Ju faleminderit shumë z. Shkodra.

Unë jam Blerim Haliti, përfaqësoj Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Profesor Enveri i përmendi dy dimensione ose një dimension. Unë besoj se, sa i përket Projektligjit për kualifikime, ne nuk guxojmë t'i lejojmë vetës dy dimensione. Ky ligj nuk është një ligj që e rregullon çështjen e kualifikimeve për një ministri, mirëpo qëllim esencial është që ta rregullojë çështjen e kualifikimeve në nivel të vendit.

Ndoshta gjatë punës tonë ka pasur pak mangësi, ato me siguri nuk kanë qenë të qëllimta, e kemi pasur një plan veprimi për vitin 2006, ai ka qenë transparent, me atë plan veprimi ka qenë i njoftuar edhe Komisioni për Arsim dhe Shkencë pranë Kuvendit edhe në planin për vitin 2006, ka qenë i paraparë që gjatë vitit 2006 të hartohet draft ligji për kualifikime. Edhe këtë e kemi bërë na me mbështetjen teknike që e kemi pasur, asistencën e Kosvetit edhe në momentin kur është hartuar ky draft ligj, unë kam pas thënë se ky draft ligj është më i mirë sot se i Maltës, mirëpo është larg prej atij të Irlandës, do me thënë është një ligj mesatar.

Sa i përket propozimit se prej kujt duhet të vij propozimi prej Komisionit apo prej MASHT-it, unë mendoj se ky problem është shumë i vogël edhe nuk duhet të

qoj peshë, ky mund të vijë edhe prej Komisionit pasi ka autoritet, të merr iniciativë për propozim, bile kështu kanë qenë edhe konkluzat e Konferencës të mbajtur në “Vila Gërmi” me dt. 13. korrik të vitit 2005, pasi jemi kthyer nga Dablina. Mirëpo, mendoj se draftligji cili është për juve, është një dokument mjaft esencial edhe tash kemi mundësi pak t’i harmonizojmë pak më mirë qëndrimet ndërmjet grupit të Dablinit, anëtar të cilës janë edhe anëtarët e Komisionit për Arsim, dhe kërkoj që Ky projektligj të procedohet më tutje nëse ka vërejtje prej dikujt, ndoshta ka mundësi edhe të modifikohet apo plotësohet, mirëpo çështja se prej kujt merret iniciativa, për mua nuk është esenciale, esenciale është që ai të procedohet më tutje. Ju faleminderit!

KRYETARI ENVR HOXHAI – Ju faleminderit! Njashtu

Unë jam DEJVID HENDLI dhe unë vij nga Projekti **Kosvet** si udhëheqës i këtij Projekti. Dëshiroj t’i falënderoj të gjithë ata që referuan tek projekti jonë, që janë falënderuan për punën tonë.

Ne ofruam përkrahjen teknike, mirëpo shumicën e punës e kanë bërë anëtarët e Grupit. Deri në fund të verës së kaluar ne e kemi pasur një Projektligj shumë të mirë. Mirëpo, që nga atëherë për të pas njohuri më të mëdha, ne i kemi bërë edhe disa vizita nëpër shtetet e ndryshme, ne po ashtu kemi përfituar edhe këshilla ligjore nga një këshilltar i cili punon në OSBE nga Dablina edhe disa komente nga ITIEF-i. Ne e kemi bërë më të mirën që kemi mundur për të arritur edhe përmirësime tjera edhe po ashtu ne kemi bërë që të ftojme edhe një ndërkombëtar tjetër për ta plotësuar punën, edhe çka unë mund t’ju them tash, mund t’ju sigurojë se punën që e kemi bërë mund të jetë e krahasueshme me ligjet tjera në shtetet e jashtme.

Çështja kryesore që ne e kemi pa të vështirë, është implementimi i rregullimeve institucionale është e qartë se shteti se siç është Irlanda i ka të rregulluara shumë mirë institucionet që i kryejnë këto punë. Shumica e tyre, të cilët i kanë të punësuar një numër të madh të punëtorëve, e kanë edhe buxhetin e madh, normal për t’i paguar ata. Qëllimi kryesor ka qenë se çka mund të bëjmë ne për Kosovën që të jetë në një rrugë të mirë edhe që të mos prodhojmë ose të mos hartojmë diçka që do të jetë e ndaluar për shkak të shpenzimeve që do të kërkojnë për këtë ligj. Edhe çështja që ne nuk kishim dashur ta bëjmë është e fundit do me thënë kjo, është që nuk dëshirojmë ta kemi një ligj i cili nuk mund të implementohet për shkak të financimit të tij. Qëllimi kryesor që tash e kemi në draftin e fundit është se ne e kemi pasur edhe disa çështje të elaboruara e cila e siguron bazën për implementimin në faza për të siguruar se çështjet themelore ose më kryesore mund të fillohen që tash, dhe disa çështje tjera që kanë më pak rëndësi mund t’i fillojnë se të kryet puna me te pak ma vonë.

Më lejoni ta përfundoj, ne jemi duke punuar në nivelin teknik, ne dëshirojmë që të ofrojmë asistencë teknike ose ndihmë teknike dhe tash është fundi i procesit politik dhe brenga ime kryesore është që ju të jeni në gjendje, të keni mundësinë që sa më shpejtë ta bëni implementimin e këtij ligji, do me thënë ne e kemi buxhetin, kemi bazën financiare që mund t'ju ndihmojmë për dy vitet e ardhshme, për shkak se kontrata jonë vazhdon deri në vitin 2009, kurse sa i përket neve, ne shkojmë kah ajo që mos të humbim aspak kohë për këtë ligj.

Ne jemi në gjendje që të përkrahim këtë ligj edhe punën e kësaj për çfarëdo pune tjetër që ka të bëjë me kualifikime, dhe sa më shpejtë që ky ligj hyn në fuqi na aq më shpejtë do të ndihmojmë për implementimin e tij. Ju faleminderit!

KRYETARI ENVER HOXHAI – Dikush tjetër?

Unë jam HIVZI DRAGIDELLA - Fillimisht dua të shprehi, do me thënë kur kam ardhur në këtë takim nuk kam menduar se duhet të deklarohe mi individualisht, prandaj edhe nuk kam qenë edhe i përgatitur, por megjithatë duhet të them disa fjalë rreth punës së Grupit të ashtuquajtur të Dablinit. Unë kam pasur kënaqësinë, dhe shprehi kënaqësinë me këtë rast të punës time personale në këtë grup, grup i cili me tërë qenien i ka përkushtuar me të vërtetë, jashtëzakonisht punës rreth hartimit të Projektligjit mbi kualifikime. Një tjetër çështje, të cilën për mua ka qenë jashtëzakonisht e rëndësishme ka qenë puna e barabartë e të gjithë anëtarëve, do me thënë kolektive. Të gjitha propozimet, të gjitha vërejtjet e çdo anëtar i janë marrë në mënyrë të barabartë që kjo është për t'u lavdëruar, sepse jo çdo shtet në regjion sidomos e ka pasur këtë karakteristikë.

Çështje tjetër, të cilën do ta theksoja është çështja që të gjithë ne, qysh si anëtarë të Grupit punues ashtu edhe anëtarët e Komisionit Parlamentar tanimë jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e kornizës kombëtare të kualifikimeve kjo, natyrisht fal edhe vizitave, të cilat janë realizuar në Irlandë, Maltë dhe në Estoni. Prandaj, vet fakti se sot e kësaj dite, që do me thënë prej Kuvendit propozimin për të hartuar ligjin mbi kornizën kombëtare kualifikimi, kjo është një gjë shumë pozitive dhe e çmoj këtë. Unë mund të them se personalisht, por edhe institucionin të cilin e përfaqësoj, në të ardhmen duhet me tërë përkushtimin tonë do të jemi në shërbim të kryerjes të të gjitha obligimeve të cilat dalin rreth aplikimit dhe miratimit të këtyre ligjeve dhe punët të cilat na presin. Jo vetëm të punojmë së bashku. Ju faleminderit.

KRYETARI ENVER HOXHAI – Ju faleminderit!

BESIM MUSTAFA – Nga Ministria e Arsimit - Për hir të anëtarëve tjerë të Komisionit për Arsim, gjatë vizitave që i kemi bërë edhe konsultimeve të disa

ligjeve dhe dokumentacioneve tjera, në të gjitha theksohet se përgjegjësia më e madhe bie mbi Ministrinë e Arsimit edhe Ministria e Arsimit i ka të gjitha ato kompetenca për procedimin dhe vlerësimin e përgjegjësive të cilat binë më tutje.

Ka shumë arsye me të cilat mbështetet ky vlerësim, përveç asaj është se Ministria e arsimit ka përgjegjësinë mbi arsimin e lartë, edhe arsimi i lartë është pjesë e Kornizës, por përveç kësaj, natyrisht me arsimin e lartë ka përgjegjësinë e vet të pakontestueshme Ministria e Arsimit përveç kësaj ka edhe njësinë për standarde, njësinë për vlerësimin e kurikulave dhe plan- programeve, andaj ma merr mendja që autoriteti në të ardhmen për vlerësimin e një plan-programi apo një diplome e cila kishte me u dhënë në një të ardhme, do të duhet të konsultohemi me njësinë për standardet dhe kutikula. Andaj, mendoj që kjo personalisht mendoj edhe institucionalisht mendojmë që kjo është e padiskutueshme dhe është pjesë e Ministrisë së Arsimit. Ju faleminderit!

KRYETARI ENVER HOXHAI – Ju faleminderit shumë. Urdhëroni

Jam NASER GRAJÇEVCI nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – Drejtor i Agjencisë për mbështetje në ndërmarrje të vogla dhe të mesme

Z. Kryetar, zotërinj anëtarë të Grupit Parlamentar, të Komisionit Parlamentar për Arsim, mendoj që për rëndësinë e këtij ligji ndoshta është e tepërt të flitet më shumë me qenë se më në fund përmes këtij ligji edhe Kosova do të jetë pjesë e një tregut të madh të punës, do me thënë ndërkombëtar ku qytetarët e Kosovës do të pajisen me kualifikime dhe certifikata përkatëse që do të njihen në gjithë botën.

Çka desha të fokusohem më shumë në disa gjëra konkrete, duke u nisur nga përputhshmëria e këtij ligji me kornizën ligjore që sot kemi në Kosovë, në nenin 8 do m thënë ku parashihet themelimi i autoritetit kombëtar i kualifikimeve, cekët organ i pavarur publik, me sa e di, ne nuk kemi një term të tillë deri tash, ne kemi agjenci që themelohen apo departamenti në kuadër të ministrive përkatëse. Pastaj, thuhet që zyra tek neni 12 zyra dhe personeli se Këshilli drejtues do të bëjë, gjegjësisht do ta zgjedhë drejtorin, dhe zakonisht drejtorët e këtyre agjencive apo këtyre organeve zgjidhin nga një këshill për emërim të larta, cili po ashtu do të kemi kujdes se sa është në përputhshmëri me standardet që i kemi, dhe ndoshta që është shumë rëndësishme, është mirë që po ashtu të pajisemi me një kosto të këtij të ligji, do me thënë të ndahet në periudha të caktuara kohore në mënyrë që edhe Parlamenti ta ketë më lehtë një aprovim të tillë, por edhe ne si pjesëmarrës të këtij grupi të ofrojmë një pasqyrë më të qartë për ta.

Këto ishin disa nga prezantimet e mia. Ju faleminderit!

KRYETARI ENVER HOXHAJ – Ju faleminderit shumë!

NIMON ALIMUSAJ – Ju përshëndes të gjithëve edhe më vjen mirë që u pamë dhe një herë, se jemi parë disa herë më parë. Kjo mbledhje është me shkas dhe shkas, u përmend edhe prej parafolësve çështja: kush e nxjerr këtë ligj. Fillimisht duhet të them unë e kam në dorë këtë Projektligj që e keni hartuar ju, sigurisht shumica nga ju kanë qenë anëtarë të hartuesve dhe u përgëzoj për punën e mirë që e keni bërë, ndonëse në këtë fazë asnjë ligj nuk vjen në mënyrë krejt të përsosur dhe ka vend ku mund të përmirësohet dhe të zgjerohet ose të saktësohet e tj. Doli si problem një mosmarrëveshje, Komision Parlamentar – Ministri, është fakt se Ministria e Arsimit e ka barrën kryesore për këtë ligj për sferën Ministrisë së Arsimit, natyrisht me ministritë e tjera.

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport e siç e thotë vetë emri merret me sfera shumë, shumë, të shumta dhe çdo herë është në presion të ligjeve që i vijnë Parlamentit e Komision Funksional është ky komision. Prandaj, nuk ka qenë etja e madhe e Komisionit me e marrë këtë barë – hartimin e një ligji që është më shumë shtete të Evropës që e kanë një traditë të madhe të arsimit nuk e kanë akoma, por në fillim kur ne jemi ftuar si komision prej jush që të marrim pjesë në Grupin e Dablin, nëse i keni proceset, ne e kemi konsideruar veten si pjesë ndihmëse e ministrive që e kanë marrë për sipër hartimin e Kornizës kombëtare të kualifikimeve, nuk është përmendur Ligji për kualifikimet atëherë, veç hartim i një kornize kombëtare të kualifikimeve, edhe aso kohe, unë personalisht, nëse e keni procesin kam thënë: ne si komision mund të marrim përsipër hartimin e ligjit se është traditë, nuk do të ndodhte vetëm me këtë ligj, por kemi edhe ligjet tjera që komisionet i kanë nxjerrë. Nuk ishte qëllimi që Komisioni ta merr këtë barë dhe nuk do ta hartonte pa ju, por ndihma jonë ishte pikës së pari e shtimë në program të Kuvendit, të futet edhe pastaj të komunikojmë me ministritë e ndryshme për buxhet etj etj. dhe e morëm për sipër dhe i bëmë një kërkesë Kryesisë së Kuvendit që ky komision të hartoj Ligjin për Kornizën kombëtare të kualifikimeve dhe të futen në program, dhe ata e kthyen përgjigjen, sigurisht e keni përpara edhe e caktuar afatin kur duhet të kryhet. Deri këtu ka qenë komunikimi shumë i suksesshëm, ndonëse ndonjëherë ka ditur Ministria e arsimit me e ftuar individin e jo Komisionin, dhe kur ai individ nuk ka shkuar në ato thirrje është akuzuar krejt Komisioni, bile ndonjëherë edhe është fyer.

NIMON ALIMUSAJ - Kur e marrim për sipër kërkuam edhe ndihmën e të jashtëm edhe e marrim një ndihmë nga OSBE-ja. Ne kemi qenë edhe një javë në Dablin, dhe kemi marrë informata shumë shtesë në krahasim me të parët, kemi kontaktuar njerëz shumë të përgatitur për këtë sferë. Ne kemi kërkuar nga OSBE-

ja edhe ekspert të ndryshëm duke menduar të përgatitemi sa më mirë se nuk kishte leje të hartimit të këtij ligji. E keni parë vetë sa i vështirë është, ku mori zjarr problemi. Problemi mori zjarr kur u mbajt kjo në Gërmi. Edhe ne nuk patëm ftesë. Me datën 14 po më duket i është quar komisioni do emrave, tash këtë mund ta vërtetojmë dhe thotë konfirmojë ardhjen e juaj me datën 13. tash pse doli komisioni, tash po del i papërgjegjshëm para Kuvendit, ka marrë për sipër nuk po din asgjë vetëm kur po del ligji.

Deshëm e nuk deshëm ky ligj do të kalojë nëpër mjet komisionit për arsim dhe me gjitha ligjet që kjo ministri ose ndonjë ministri e juaja ka paraqitur komisioni është marrë me javë të tëra në amendamentimin, se ne jemi komision funksional dhe nëse ju e hartuat dhe se kërkuat ndihmën përveç atyre vizitave që i kemi bërë bashkërisht ne tash e kërkojmë ndihmën e juaj në amandamentim dhe do ta mirëpresim, për ndryshe unë pajtohem që kjo punë nuk do të shkojë kot, ne do ta kemi një arsyetim para Kryesisë së Kuvendit, kryetari sigurisht ka kontaktuar edhe me kryetarin e Kuvendit, nervozë nuk ka qenë e paktë, prej gjithë anëtarëve të Komisionit. Pse ky komunikim, shumë kujt nuk si ka ardhur fare ftesa prej këtyre njerëzve që kanë qenë në Dablin për të dytën herë, krejt komisioni komplet, po pse bash ditën e fundit që mund mos të jetë aty të ketë një agjendë tjetër, sidoqoftë edhe një herë ju përgëzojë për krejt punët tash është në dorën tonë ky ligj edhe a do ti përngjajë ky si thotë një studiues, sa do të kemi dorë ne tash më tutje por me siguri do ta kemi ndihmën e juaj në amandamentim.

Ky zotëriu vetëm paraqiti elementet që duhet përmirësohet ju faleminderit.

KRYETARI ENVER HOXHAI – ju faleminderit z. NIman.

Luan Alma – Universitetin e Prishtinës në këtë grupin punues. Më duket që pas diskutimit profesor Nimonit nuk di a ka biseda ma tjera këtu, ai tha që ligjin e ka në dorë dhe u krye puna.

Kam marrë pjesë mjaft në këto takime dhe mund të them lirisht që kam qenë një farë mënyre si palë neutrale. Po e them si palë neutrale sepse prej fillimit është zhvilluar një farë debati të them në mes të ministrisë së arsimit dhe ministrive tjera problem social.

Thotë gjithmonë fjala te themeluesi kur ka qenë ka qenë pikëpyetje shumë e madhe MASHT-i ka tentuar që të jetë gjithmonë themelues, këta tjerët janë vërsul që as kategoritë që duhet me qenë MASHT-i edhe ky ligj që tash e keni në dorë e ka defektin e vetë që nuk dihet kush është themelues. Bile këtu shaka shpesh kam propozuar që të jetë OSBE-ja themelues, sepse nuk mujshim ta gjejmë kush është themeluesi, pse me qen MASHT-i pse me qen ky pse ai, prandaj edhe kur e shihni e lexoni me kujdes keni me parë që vërtetë janë disa nene ndoshta pak me

kontradiktë sepse nuk dihet saktë kush e themelon dushkujt i përgjigjet, ne herën e fundit kemi bërë disa kompromise, disa me i jap formë por themelohet është organ i pavarur me mbështetje të këtij ose atij, më duket se nuk ka deri më sot ligje që themelohet diçka në mbështetje të thjeshtë edhe atij, kjo ka qenë në një farë mënyre me kënaq ministrinë e arsimit, edhe ministritë tjera që mos me qenë prandaj komisioni për arsim edhe punë tjera çka janë në komision, unë mendoj se ka me pas punë në këtë ligj më tutjeshme me e propozuar saktë kush është themelues këtij agjencioni ose autoriteti, sepse kështu besoj se edhe ju keni me pa që më duket disa nene janë në mes veti, kundërthëniet thjeshtë nuk dihet kush është ai që e themelon këtë ligj këtë autoritet.

Çështjes e dytë që po diskutohet këtu kush e nxjerrë këtë ligj, më duket ajo nuk është çështje për diskutim sepse a e inicion komisioni i juaj apo ky grup, aspak nuk është me rëndësi, me rëndësi është që ta kemi ligjin, më duket këta kolegët që kanë punuar në këtë ligj ose propozim as një nuk do të jetë i ofenduar në qoftë se Kuvendi del që kjo është iniciativë e komisionit për arsim, sepse asnjë nuk jeni këtu me nxjerrë dhe me propozuar ligjet, por dikund do të shkruan sigurisht që prandaj kemi marrë pjesë në këtë. Prandaj askush nuk duhet me ndie veten të ofenduar.

Pra, çështja e iniciuesit nuk është dashur të diskutohet fare. Kurse çështja e themeluesit mendoj që është këtu shumë më më duhet që me kujdes të madh të shihet çdo nen sepse ka në mes të rreshtave saktë nuk dihet kush është themeluesi që tash për tash, së paku për mua është shumë enigmatik themeluesi. Ky në mbështetje të tij ose atij. Ju faleminderit.

KRYETARI ENVER HOXHAI – Ju faleminderit shumë prorektor, profesoresha Gjylshen Berisha – anëtare e Komisionit.

GJYLSHENE BERISHA – Unë do ta falënderoja këtë grupin e Dablinit të them kështu. Grupin punues të këtij projektligji për punën që e ka bërë, pajtohem me atë se nuk është me rëndësi se kush është hartues, është me rëndësi të kemi një ligj të mirë.

Ne që e kemi marrë dhe e kemi paraprirë punës që e ka pas komisioni sigurisht keni pasur parasysh se ne si komision parlamentar i arsimit kemi shumë punë dhe keni dashur të na kurseni, faleminderit për këtë.

Unë do të përqendrohesha, nuk është me rëndësi, me rëndësi është të kemi një ligj të mirë. Ne kemi qenë, edhe ju keni qenë në Irlandë edhe ju keni qenë dhe kemi parë se sa ka arritur Irlanda përmes këtij ligji dhe përmes kualifikimeve që i kanë pasur që ta arrijmë një standardë që vërtetë që të jenë në një zhvillim ekonomik të

lakmueshëm në Evropë. Shpresojmë që do të jetë një ligj i tillë që do të na e qel atë rrugë edhe neve, por këtu te neni 8.

Autoriteti kombëtar i kualifikimeve është organ pavarur publik nën një . E dyta. I themeluar nga Ministria e Arsimit, 3. vepron marrëveshje me zyrën e kryeministrit, 4. dhe ministrive relevante dhe partnerëve social, domethënë i ka pesë tutor përmbi kokë.

Ne si komision i kemi lënë për detyrë që ta caktojmë kënd do ta ketë tutor dhe ne do ta bëjmë , do ta bëjmë ashtu si është interes të arsimimit apo të rikualifikimeve apo të kualifikimeve.

Kjo është njëra prej vërejtjeve dhe që desha të kontribuojë për ndrysh ju faleminderit.

KRYETARI ENVER HOXHAI – Ju faleminderit profesoreshë.

HYSNI TERZIU – Ju përshëndes të gjithëve dhe njëkohësisht, me gjithë se ne kemi marrë pjesë edhe ma herët edhe herën e fundit kështu ma tepër. Mirëpo, kisha të diskutojë edhe unë ashtu, profesoresha e tha para meje, duke u nisur nga neni 8. te themelimi.

Është themelimi i autoritetit kombëtar për kornizë, dhe kjo bashkëngjitet themelimi funksionimi dhe organizimi i autoritetit kombëtar për e Kosovës, njëkohësisht të gjitha që u thanë nga profesoresha edhe unë jam për atë se duhet të dihet me të vërtetë të harmonizohet shumë mirë dhe të parashihet me ligj, se si duhet të themelohet, kush duhet ta themelojë dhe të harmonizohet ky nen. Për ndryshe ky nen komplet tek njëshi nuk është mirë. Mandej edhe te funksionet lidhet.

Disa funksione i kemi, funksionet e AAK-së nuk e di a duhet të jetë edhe funksioni kontrollit, funksionet ekzekutive apo edhe funksioni i akteve nënligjore apo drejtë ky që të formojë ndonjë akt nënligjor në bazë të këtij ligji. Apo edhe funksionet tjera.

Neni 9, ku është anëtarësia e autoritetit kombëtar kualifikimi ose kornizë kombëtare për kualifikim të Kosovës është, kështu sipas mendimit tim duhet të hiqet ajo anëtarësia dhe të bëhet emërimi i anëtarëve, sepse anëtarësi këtu ne nuk kemi të bëjmë me anëtarësi por duhet të caktohet titulli. ... neni 9 emërimi anëtarëve, kurse 9.1. p.sh. autoriteti kombëtar për kualifikime të Kosovës përbëhet nga 13 anëtarë ku të gjithë anëtarët emërohen në bazë të neni 9. e jo kështu të shkohet në këtë mënyrë. Ose 9.2. anëtarët e AAK-së domethënë duhet të emërohen nga Kuvendi këtu nuk e kemi ashtu, edhe unë nuk e di 9.5, unë besoj që

edhe Qeveria është këtu ta themelojë një komision profesional ku do të mirët me emërimin e këtyre kandidatëve sigurisht dhe në bazë të emërimit të këtyre kandidatëve ia prezanton Kuvendit të Kosovës,

Te neni 10. na mungon kjo mbledhje e AAK-së duhet të hyjnë nën nen 10.1 10.2 ose diçka tjetër, kurse titulli neni 10 sipas mendimit tim duhet të jetë organizimi dhe votimi i autoritetit kombëtar për kualifikime të Kosovës.

Mendoj se duhet shikojmë te shpërdorimi i pozitës që e ka ky autoritet dhe caktohet sipas nenit caktohet edhe sanksioni ose shpërdorimi, po ashtu edhe te, nuk kam mundur me vërejtur si është e saktë cili nen dhe cili nën nen bën shkarkimin dhe suspendimin e anëtarëve të këtij autoriteti.

Njëkohësisht në fund i kemi dispozitat ndëshkimore d.m.th. çështje juridike çka do të thotë se duhet të përcaktohet edhe me ligj, shkeljet e ligjit që bëhen, nëse komisioni ose autoriteti nëse bën shkelje të këtij ligji atëherë çka, ju faleminderit.

KRYETARI ENVER HOXHAI – urdhëroni

FIKRIJE ZYMBERI – unë vetëm desha tu përgjigjem se nuk e di se kemi bërë ndonjë ftesë që kemi anashkuar.

Ministria si ministri, se për ndryshe takimet që kanë të bëjnë me këto procese nga ana e jonë që kemi jemi marrë me këto procese që nga fillimi çdo herë këtë e dinë edhe anëtarët tjerë që çdo herë kanë qenë ftesat në emrin e juaj se ne aty gjithë herë kemi llogaritur mbështetjen pr..... politike. Edhe sa i përket këtyre diskutimeve sot që po diskutohen besoj që ne mund të caktojmë një plan veprime çka më tutje ndoshta mund të caktojmë ndonjë ditë të ardhshme që të diskutojmë bashkërisht se ku duhet të intervenohet se sa e di unë domethënë të merremi vesh se si do të procedohet më tutje ky ligj, unë mendoj kështu, të tjerët mund ta thonë mendimin e vet.

Ndoshta do të zgjatet pak më tepër por të jemi më konkret të kemi një plan së shpejti çfarë do të veprojë më tutje. Të kemi krejt anëtarët e komisionit prezentë, dhe është me rëndësi që puna të ecë përpara.

KRYETARI ENVER HOXHAI – ju faleminderit, a ka dikush të shton diçka.

BLERIM HALITI – Në konferencën e dytë për kornizë kombëtare të kualifikimeve me 10 nëntor 2005 e kam pas një prezantim dhe në fund të prezantimit kamë thënë që është privilegj për ne që anëtarë të grupit tonë janë edhe anëtarët e komisionit, këtë nuk e kam thënë me diplomaci por e kam thënë me sinqeritet. Tash në qoftë se janë bërë lëshime unë besoj që nuk është mirë me u

marrë fort me të kaluarën, mirëpo çka nesër, këto nuk janë politika tona, mirëpo këto janë politika të bashkimit evropian të komisionit, përmes te ne edhe sot janë rekomandime të BES që çdo shtet deri në vitin 2008 duhet të ketë një kornizë kombëtare të kualifikimeve.

Sot është vetëm rekomandim ndërsa nesër obligim, unë kisha kërkuar që të mos merrem me çka dje, mirëpo çka nesër na pret edhe presim me të vërtetë diçka konkrete prej komisionit se cila do të jetë hapat drejt finalizimit të draft ligjit deri te aprovimi i tij dhe implementimi në praktikë.

KRYETARI ENVER HOXHAI- Profesoreshë urdhëro.

NAGJIJE DOQI – Ju faleminderit z. kryetar, i përshëndes të gjithë përfaqësuesit e të gjitha ministrive këtu, përshëndes edhe anëtarët e komisionit, edhe z. Dejvid.

Të nderuar, mua më vjen mirë që të paktën këtu u tejkalua ajo mbetja e hatrit se kush do të jetë autor i këtij projektligji. Tejkalmi do të thotë është ajo që ne na hap rrugë që të vazhdoj me procedimin e mëtutjeshëm të këtij projektligji që ka nevojë normal që të përpunohet, sepse ishte dilema vërtetë është dhënë kontribut unë jam në legjislacion të dytë por kujtoj që komisioni ka bërë një punë shumë të madhe në bashkëpunim edhe me grupin me koordinatorët që vetë që është bërë ndoshta pak te komisioni ka krijuar atë se pse mos të jemi ndoshta prezentë gjatë finalizimit gjerë të këtij rekomandimi.

Këtu ndoshta ka qenë ajo dilema për ndryshe ky mirëkuptim tani që kujtoj që u arrit që na bën neve që si komision që ne të përqendrohemi më tepër se ndoshta nuk jemi përqendruar të japim vlerësime si duhet se ka nevojë për përmirësime për intervenime por vetvetiu ta quajë edhe koncenzus kesi soji që u arrit këtu unë si anëtare e komisionit shprehi atë pajtueshmërinë do të thotë më vjen mirë që erdhëm gjer te kjo se komisioni, ministria e arsimit, ministrinë tjera që kanë kontribuar këtu vetë grupi që ka kontribuar është një punë e madhe dhe finalizimi do të na qoj te një ligj që domosdoshmërisht duhet ta kemi si ligj ku në mes të cilit do ti kryejmë obligimet tona ku do të bëhet implementimi i këtij projektligji dhe në të ardhmen kontributi do ta bëjë edhe më të mirë këtë. Ju faleminderit

KRYETARI ENVER HOXHAI – ju faleminderit profesoreshë. Donë edhe dikush fjalën , nëse ju më lejoni në formë sa më të shkurtër ta përmbledh këtë takim si ne komision po e shohim planin e veprimtimit për ligjin konkret.

Kisha pas në fillim ti jap disa argumente shtesë rreth qasjes tonë.

1. Ky ligj do të jetë referencë për shumë ligje që deri më tash janë miratuar në Kuvendin e Kosovës, dhe pse janë miratuar ky do të jetë referencë për ta,

- po do të jetë pikë referuese edhe për ligjet tjera të cilat do të miratohen. Dhe nuk kanë të bëjnë vetëm me ligjet që i takojnë fushës së arsimit dhe të aftësimeve po definitivisht me ligjet që kanë të bëjnë me ekonomi me tregti me politika fiskale dhe me çdo gjë. Dhe kjo tregon se sa serioz është çështja.
2. Ky ligj definitivisht do ta formsojë ndjeshëm edhe debatin që e kemi ne si komision për ligjin për arsimin privat i cili është në punë e sipër në këtë komision ku në mes deputetëve të Kuvendit të Kosovës në mes komisionit tonë ka qasje vërtetë a duhet apo s' duhet të ketë ligj për arsim privat. Unë sot kam pas takim me kryesi të Kuvendit një pjesë e anëtarëve të kryesisë së Kuvendit nuk ishin të interesuar fare për arsim privat. Ne si komision kemi menduar ndryshe para dy viteve, tash më tepër të interesuar jemi në favor edhe të ministrisë së arsimit edhe institucioneve të arsimit privat. Do të thotë e definon edhe e qartëson shumë se çfarë duhet ndodhë me ligjin për arsimin privat.
 3. Këtë ligj kanë marrë pjesë shumë institucione shumë aktor kyçë relevantë, për mendimin tim ministritë kyçe edhe institucione kyçe edhe partnerë social edhe Oda Ekonomike edhe kemi pas mbështetjen e shumë të tjerëve, por definitivisht pronësia është e vogël edhe më tutje, se shpesh herë ne kalojmë ligjin në Kuvendin e Kosovës dhe tani e shohim që aktorë të ndryshëm kanë problem me implementimin e ligjit se gjatë draftimit të ligjit nuk e kemi marrë në konsideratë, me qëllim që mos ta kemi një situatë që në vitin 2008 e shohim që ligji për disa pjesë të shoqërisë nuk është i zbatueshëm, ne si komision duhet ta mendojmë së bashku me juve edhe kënd tjetër vërtetë do të duhej ta ftojmë në një debat të tillë si shembull po ju përmendi. Neve na ka ndodhur për ligje të caktuara të kemi punë me KEK-un ose me postën se ai ligj ka pas të bëjë me aftësimet trajnimet e punëtorëve të këtyre institucioneve të agjencioneve publike që i kemi në Kosovë. A disa prej kandidatëve e përmendi çështjen e fazës së tranzicionit. Do të thotë miratohet ligji, vjen korniza kombëtare e kualifikimeve, parashihet një fazë e tranzicionit si të harmonizohen institucionet që janë aktualisht me institucionet tjera të cilat duhet të krijohen kjo vlen sidomos edhe për atë se çfarë relacioni duhet të ketë agjencia për akreditim të arsimit të lartë çfarë roli duhet të kenë komisionet të cilat janë pranë universitetit të Prishtinës, çfarë roli duhet të kenë institucionet e arsimit privat qofshin të arsimit të lartë dhe çështje e tranzicionit për neve ka qenë ndër fushat e reja të cilat i kemi shkelë për herë të fundit

Kur kemi qenë në Irlandë kur e kemi pa që tranzicioni atje ka qenë ma problematik se sa që kemi mendua ... që ngritje dhe Dejvid Hendëll në faza të ndryshme.

Çështje në veti është edhe buxheti, sa mundësi financiare ka Kosova që ta e... një ligj të tillë, kur kemi qenë para fundit në Irlandë, ne na është thënë që krejt ato institucione që i kemi vizitua prej 2004 ose 2005 së bashku në Irlandë hitaku, fytaku, më tepër kanë qenë kompromis i rrethanave që i ka pasur Irlanda se sa kanë qenë zgjidhje ideale dhe ne e kemi një përparësi që ndoshta mund të qasemi përmes zgjidhjeve ideale me qenë institucione të tilla, a edhe nëse për famë ekzistojnë diku, definitivisht nuk e kanë, nuk janë edhe aq shumë funksionale, ka në ligje për arsimin fillor e të mesëm, në ligje tjera lloj lloj këshilli i cili është i sugjeruar për lloj-lloj pune dhe krejt këto këshille duhet të shihen se si të inkorporohen në këtë ligj. Ka modele gjermane, ka modele sllovene, ka lloj-lloj modele të cilat duhet të harmonizohen me këtë ligj.

Kështu që, na si Komision kishim qenë të interesuar që ta ndjekemi për këtë ligj një rrugë sa më të shkurtë dhe rruga sa më e shkurtë për neve si Komision në përputhje me disa ligje që i kemi draftua si në fitin e kaluar, një ligj shumë më problem se sa ky ligji për trashëgimi fulturore të Kosovës, pjesa më e madhe e punës është kryer para se të kalon në leximin e parë. Meqë nëse ky ligj në këtë formë dorëzohet në Kuvend të Kosovës dhe ngritën dilema qysh u ngritën dilema për nenin 8. a do të jetë organ i pavarur publik, çka nënkupton organi i pavarur publik dhe versioni i parë i draftit, ka ndryshime shumë të mëdha në tekst, atëherë nuk mund të kalon në leximin e dytë, po duhet ti ketë tri lexime. Çka do të thotë ciklin e procedurës në Kuvend të Kosovës e zgjatë shumë më tepër.

Me qëllim që cikli të jetë sa më i shkurtër, që të kemi dy lexime, ne kishim qenë të interesuar që, këtë ligj fillimisht në kuadër të punës tonë si komision, para se ta adresojmë në Kuvend të Kosovës, të shohim se çfarë pune shtesë mund të bëjmë. Për atë mendimi jonë ka qenë prej fillimit që të pyesmi organizata donatore, po mendoj edhe Ko.... edhe OSBE-n, po edhe organizata tjera donatore, ku thjeshtë një ekspert i cili definitivisht do të duhej të paktën ti lexojë krejt ligjet që kanë kalua në Kuvend të Kosovës, një pjesë të madhe të ligjeve relevante, kogjo detalshëm dhe të shoh se çka parashihet në ato ligje dhe se si këto ligje të jenë në harmoni me ligjin për kornizë kombëtare të kualifikimeve që do të jetë referencë. A të shihen dhe të mendohet faza e tranzicionit dhe masandena të jemi në shërbimin e juaj, si Komision në momentin kur do të punohet më intenzivisht në Kornizë kombëtare të kualifikimeve, të bisedohet edhe një herë më shtruet edhe me ministrinë e ekonomisë dhe të financave, për financim, ndoshta edhe me zyre të Kryeministrit për financim, cilat do të jenë mundësitë financiare në vitin 2008 nëse fillon implementimi i këtij ligji dhe e gjithë kjo neve na shtron para një dileme nevojën e një eksperti ndërkombëtar, definitivisht duhet të jetë dikush i cili

reflekton mirë, diskursin evropian sa i përket kornizës evropiane për kualifikim dhe i cili është përgatitë mbi të gjitha nga ju çka jeni të pranishëm këtu, synon të harmonizon me orientimet kryesore të asaj se çfarë ka parasysh Komisioni Evropian në të ardhmen, dhe mbi të gjitha edhe me realitetin tonë ekzistues.

Kjo është do të thotë se si e shohmi si Komision na pas konsultes edhe me profesorin Nimon, po edhe mbas konsultes që kemi pasur gjatë këtyre javëve të fundit me të gjithë anëtarët e Komisionit dhe nëse ju jeni të gatshëm për një plan të tillë të veprimit ne veç e kemi bërë një shkresë e cila ende nuk ka mbërritur, për çka falënderoj Blerimin shumë që ta lusin OSBE-në, meqë zoti Deivid Hendëll është këtu dhe kemi pasur çdo herë bashkëpunim të shkëlqyeshëm edhe një herë po shprehim interesin e Komisionit që ndihmohemi, meqë në bazë të kësaj çka i përmende qito argumentet më kyçe po shihet që ka kështu shumë punë realisht na jemi krejt në fillim, dhe në momentin do të thotë inicimi i ligjit në Kuvendin e Kosovës përmes Komisionit do të jetë vetëm fillimi.

Jam shumë i sigurt që në momentin kur kalohet në leximin e parë, na do të shohmi se si komisionet tjera do të reagojnë ndaj këtij ligji se shpesh na ndodhë se shpesh na ndodhë se komisionet tjera krejt ndrysh i lexojnë ligjet për arsim në krahasim me na se si i lexojmë dhe masandej do të shohemi se si do të janë edhe mundësitë që së bashku me Komisionin për buxhet të bëjmë bllokim pranë Ministrisë për ekonomi dhe financa që definitivisht vitin e ardhshëm të paktën zyra e kryeministrit ta ndajë një pjesë të madhe të buxhetit.

Kjo është se si na si Komision i shohim nëse anëtarët e Komisionit, profesor Nimon urdhëro, nëse dikush prej komisionit është i interesuar të shtoj edhe diçka është mase i mirëseardhur, madandej po ua japi fjalën juve profesor.

NIMON ALIMUSAJ:

Desha vetëm një sqarim u shtrua edhe prej zonjës Fikrije edhe prej disave çka më tutje, cila është procedura, procedura sipas Rregullores së Kuvendit është kjo: sponzoruesi e qon në Kryesi të Kuvendit projektligjin, Komisioni nuk e ka në dorë, as në leximin e parë që aprovohet në parim Komisioni nuk jep qëndrimin e vetë.

Komisionit i vjen sipas rregullores po them që është në fuqi, i vjen mbas leximit të parë si Komision funksional që merret me amendamentimin e tij. Edhe atëherë Komisioni i qon amendamentet, nëse ndodhë kjo si e tha kryetari kjo rrugë shkon e gjatë se nëse p.sh. dalin më shumë amendamente se nene, atëherë kalon në leximin e nuk e di deri kur shkon. Unë kamë do informata se është nifur iniciative në ndryshimin e rregullores ku Komisioni ta marr para se të kalojë në leximin e parë qenka një ekspert nga Estonia duke punuar në këtë.

Pa marrë parasysh që nuk është ndryshua ajo rregullore d.m.th. Komisionit i vijen veç mbas leximit të dytë, të parë, tha kryetari ne po him bashkërisht që të shkojë në një formë sa më të përkryer që kur kalon në amendamentim mos të ndodhë me kalua në leximin e tretë, se atëherë nuk e di deri kur shkon. Veç procedura që është në fuqi deri tash është që na të merremi me to veç mbas leximit të parë.

Gatishmëria që e tha kryetari qysh tash para se të kalojë në Kryesinë e Kuvendit në leximin e parë të hyjë në rend dite, tregon se ri interesimi i komisionit nuk ka qenë ta pengojë ligjin po krejt ka qenë i nervozuar për mos akordim të punëve.

Sa i përket asaj që tha Fikrija nuk është fjala për këtë grup që ne kemi pasur probleme, por janë bë ftesa individuale kur individ i nuk ka shkua në thirrje atje atëherë janë qua letra fyese për Komisionin, janë que letra që nuk i banë toka, kemi pasur probleme, veç jo me këtë grup.

U bë problem edhe në Kryesinë e Kuvendit edhe te kryetari i Qeverisë,

DAVID HANDLY:

Sipas pyetjeve që u bënë, ne punojmë shumë ngushët me OSBE-në, dhe mund të koordinojmë punën, e po ashtu edhe me IDIF-n i cili dëshiron që të asistoj në këtë proces, për momentin ne jemi në gjendje në atë situatë që mund ta gjejmë një ekspert i cili do të jetë i përshtatshëm për të përkrahur procesin edhe ne i kemi propozuar disa emra të cilët do të jenë të përshtatshëm për këtë punë.

ENVER HOXHAI

Unë nuk jam i thirrur që të flas në emër të të tjerëve, por më lejon si një pjesëmarrës i një takimi që kemi pasur me OSBE-në dhe e kisha lutë Blerimin masandej që ndoshta të reflekton në pozitën që e ka si përfaqësues i ODBE-së. Me komisionin, na si komision kemi qenë të gatshëm ekspert i që vjen për me na ndihmua neve për ligjin për kornizë kombëtare të kualifikimeve për të gjitha këto dilema që unë i shtrova që i kemi të shtruara dhe të detalshëm në formë të shkrueme, ekspert i njëjtë ta ndihmon që ky ligj të jetë sa më i përsosur dhe ta reflektoj strukturën ligjore, realitetin në Kosovë, edhe debatin në vet, brenda për brenda Bashkimit Evropian, dhe që ky ekspert punoi edhe me komisione edhe me ministri të arsimit, do të thotë nëse ne e gjejmë një ekspert eminent i cili do të ishte në gjendje neve të na ndihmon që të kalon ligji, ndoshta ekspert i njëjtë do të ishte në gjendje masandej ta ndihmon grupin e Dablin, në tejkalimin, do të thotë në draftimin e kornizës kombëtare të kualifikimeve. Ne jemi mase të interesuar që kjo të ndodhë dhe si Komision do të thotë veç çka e kishim pasur benificionin më të madh se e kishte reflektua definitivisht realiziteti kështu në formën më precize se çfarë po ndodhë edhe në ministri të arsimit ose në ministri tjera për projekte konkrete.

Po do të thotë unë nuk jam i thirrur të flasë në emër të OSBE-së, veç po ju reflektor se si ka qenë e menduar në takimin e fundit që kemi pasur.

BLERIM SAQUIPI: nga OSBE, departamenti i arsimit të lartë.

Po është e vërtetë që kemi premtua komisionit të arsimit vazhdimësinë e përkrahjes tonë për çështjen e ligjit mbi kualifikime si vazhdimsi vizita që ka qenë në Dablin, dhe me marrjen e ftesës zyrtare do të thotë ne do të jemi në gjendje të jemi në bashkëpunim me partnerët tjerë do të thotë të ju ofrojmë këtë ekspertizë ligjore apo arsimore për Komisionin apo për procesin më saktësisht.

Mendoj se ato që i tha ishin pak a shumë një përmbledhje e asaj që kemi bisedua.

ENVER HOXAJ

Ju faleminderit shumë, mirë duke qenë do të thotë jemi në fund të takimit nuk di a ka nevojë të bisedohet a diçka në formë më të detalshme të mundshme, ne si Komision do të vijmë me planin e veprimin në formën konkrete pasi të bisedojmë edhe me donatorët e mundshëm se kurë teknikisht ky ekspert kish mund të vije në Kuvend të Kosovës dhe të na ndihmon, janë edhe ato dilemat teknike se ku duhet të jetë i bazuar ai ekspert, kështu që meqë ju jeni shpesh herë edhe prej ministrive të caktuar, kishen mirë që të shihni edhe mundësinë e ndihmesës së tij herën e fundit kemi pasur problem deri sa e kemi gjetur një zyrë në OSBE, na në Kuvend të Kosovës nuk kemi hapësirë shumë për punë, kështu që të gjitha këto dilema duhet të mendohen ku duhet të jenë i stacionuar ai ekspert i cili duhet të vije, dhe mbi të gjitha për ne çka është e rëndësishme është kjo çka e potencoi në formën më të qartë të mundshme profesori Niman.

Na jemi të interesuar para se ti propozohet Kryesisë së Kuvendit, para se të dërgohet në një seancë pune të Kuvendit të Kosovës për lexim, ta kemi edhe një takim, eventualisht dy takime gjithëpërfshirëse, dëgjimore të ftojme edhe njerëz tjerë, ndoshta të informave të ndryshme, por kjo duhet të ndodhë mbasi një ekspert në formë të detalshëm i sheh të gjitha ligjet që kanë kaluar nëpër Kuvendin e Kosovës dhe qysh të referohet zgjedhë çështjen e ligjit për arsimin privat, e mendon fazën e tranzicioni kogjo detalshëm që duhet ta mendojmë kogjo mirë në fazën se si duket, dhe mbi të gjitha rregullojmë çështjen e financimit. Sa buxhet duhet të ndahet, unë e kamë par një buxhet të propozuar, a edhe ajo duhet të mendohet dhe mbi të gjitha ne që prej kësaj faze ndoshta kishim qenë të interesuar që të bisedojmë edhe me agjencinë për akreditim për arsimin e lartë.

Ti pyesim ata se si e shohin, më duhet definitivisht ta vizitojmë edhe Universitetin e Prishtinës, të flasim edhe me rektorin për rektor, senatin, por nëse juve ua merr mendja do të thotë ne e kishim marrë me një plan të veprimit gjatë javëve të ardhshëm pa asnjë ... të parë se kush kishte muajt me ardhë dhe në çfarë hapësire kohore kishte muajt me ardhë me qëllim që me e krye këtë punë.

Ne si komision jemi deputet kështu me profesion, kemi edhe punë tjera dhe definitivisht nuk jemi në gjendje që të ulemi me orë të tëra dhe ti lexojmë krejt ligjet të cilat kanë kaluar nëpër Kuvendin e Kosovës që, a të jetë thjeshtë puna sa më e pastër në përmirësimin e këtij ligji.

A ka dikush të shtojë diçka jo.

Nëse jo ju falënderoj të gjithëve për këtë takim, a do të ju informojmë ndërkohë, a nëse do të keni takime për kornizë kombëtare si të tillë, do të thotë nëse veç tash mendoni që ta shtyjmë debatin e kornizës kombëtare si të tillë, ma merr mendja që neve si Komision na keni shumë në favor që të jemi në pranishëm.

FIKRIJE ZYMBERI

Besoj që ftesa tash për takimin e ardhshëm do me thënë ku do të paraqitet një plan i veprimit, do të vijë nga Komisioni i arsimit me siguri që ne do të jemi të gatshëm ti bashkëngjitemi këtij takimi. Ju faleminderit!.

ENVER HOXHAI:

Unë u falënderoj të gjithëve do të thotë për takim, zonjën Fikrije, zotin Blerim, të gjithëve të pranishëmve, rektorin Ahma, zotin Shkodra dhe të gjithëve të pranishëm, ju faleminderit shumë, do të thotë ju paraqitemi ndërkohë sapo ti kryejmë një pjesë të përgatitjeve të cilat kanë të bëjnë mbi të gjitha me aspektin financiar.

Mbledhja përfundoi në ora 16,15.minuta.